



## Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2023

Drejtoria për Arsim dhe Edukim, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, bënë këtë:

PRANUAR ME:

ACCEPTED ON: 16/05/2023

PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 11/1678

### Njoftim

#### PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E PARË PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024

Të nderuar prindër,

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë për vitin shkollor 2023/24 bëhet prej 16.05.2023 deri më 16.06.2023, në të gjitha shkollat fillore të komunës së Malishevës.

#### I. Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë

- Fëmija regjistrohet në klasën e parë pasi të ketë mbushur moshën minimale gjashtë (6) vjeç.
- Regjistrimi i fëmijës në klasë të parë para moshës minimale gjashtë (6) vjeç bëhet vetëm atëherë kur ka një vlerësim dhe rekomandim të një ekipi profesional, të caktuar nga shkolla. Ekipi vlerëson pjekurinë njohëse, sociale, motorike dhe emocionale të fëmijës duke përcaktuar gatishmërinë e fëmijës për të hyrë në klasë të parë. Vendimin përfundimtar e merr drejtori i shkollës.
- Ekipi profesional përbëhet nga psikologu, pedagogu, mësuesi mbështetës i shkollës, etj...
- Fëmija me diagnozë mjekësore para regjistrimit referohet tek ekipi komunal për vlerësim pedagogjik në Drejtorinë komunale për Arsim, në komunën e Malishevës.

#### II. Dokumentacioni

- Për regjistrim në klasën e parë, fëmija duhet të ketë certifikatën e lindjes/ ekstratin e lindjes, certifikatën e vaksinimit dhe dëshminë për vendbanimin nga komuna e Malishevës.
- Dokumentet e prindit/ kujdestarit ligjor.
- Formulari i regjistrimit plotësohet në momentin e regjistrimit pranë institucionit arsimor.
- për fëmijët që kanë ndjekur edukimin parafillor, në raste specifike mund të kërkohej edhe një vlerësim përshkrues për fëmijën nga edukatorja.

Të gjithë fëmijëve u urojmë suksese

Drejtoreshë e DKAE-ës



Arbëreshë Krasniqi